



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26.04.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Zoran Çirković- Zëvendës kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rustemi
3. Egzona Fazlija
4. Naxhije Gashi
5. Naim Jahiri
6. Arben Salihu
7. Slavisa Trajkovic
8. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës për Komunitete
2. Zoran Stankovic, ZLK
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Mbledhjen e udhëheqi Zoran Cirkoic për shkak se kryesuesi mungoi për arsye familjare, në vazhdim i përshëndeti të pranishmit, dhe tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi tha se kam një propozim që të hiqet pika e 2 e rendit të ditës pasi që edhe drejtori i SHP ka njoftuar se do të vonohet. Pastaj kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e Komitetit për Komunitete.
2. Raporti i ZLK-s
3. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Zoran Cirkovic, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime në ekstraktin nga mbledhja e 33-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 33-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Zoran Cirkovic, ia kaloi fjalën Zoran Stanojevic nga ZLK e cili në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Naim Jahiri, a keni mjete të mjaftueshme për të ju ndihmuar familjeve të cilat kanë kërkuar ndihmë.

Zoran Stanojevic, ne ato mjetet të cilat i kemi në dispozicion do të mundohemi të ju ndihmojmë aq sa kemi mundësi edhe pse kjo është ndihmë e njëhershme.

Zoran Cirkovic, tha se unë kam për ta ngritur një çështje ka të bëjë me një rast në fshatin Grackë e Vjetër ku një shtëpie i është vënë zjarri nga vet pronari nga pakujdesia pasi që e ka harru cigaren të ndezur. Unë i kam njoftuar institucionet për rastin në fjalë. Të gjitha institucionet përgjegjëse kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe ne jemi falënderues.

Mirëpo do të ishte mirë që t'i bëhej një zgjidhje personit në fjalë për banim pasi që jeton i vetëm dhe me kushte të vështira dhe ka nevojë për strehim.

Pas kësaj pike u kalua në pikën të ndryshme

III

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i takimit Zoran Cirkovic, tha se a ka dikush të diskutoj.

Zoran Stanojevic, ne si ZLK kemi pas një takim me përfaqësuesit e FSK-s dhe ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë me Komitetin për Komitete, ku e kanë një sektor për Komitete dhe janë të gatshëm edhe të marrin pjesë në takimet të Komitetit, por edhe të ndihmojnë me pajisje teknike.

Lulzim Qerimi Nënkryetar për Komunitete,ne kemi pasë bashkëpunim të vazhdueshëm me FSK-n,dhe këtë zyre dhe nuk po e shoh të arsyeshme me i obliguar me marrë pjesë në këto takime pasi që këta marrin pjesë edhe në takimet e KKS-s.

Naim Jahiri,edhe mua nuk po me duket e arsyeshme qe t'i obligojmë që të marrin pjesë në takimet e komitetit FSK-n.

Sllavisha Trajkovic,edhe unë pajtohem me parafolësit që nuk ka nevojë që të jenë FSK-ja prezent në çdo takim, po kur të shohim të arsyeshme i ftojme.

Arben Salihu edhe unë e kam mendimin e njëjtë me parafolësit pasi që në takime marrin pjesë OSBE,UNMIKU,nuk po e shoh të arsyeshme me i obligu FSK-n me marrë pjesë.

Lulzim Rustemi, i falënderoj FSK-n për gatishmërinë dhe bashkëpunimin,është mirë me i ftuar në një takim FSK-n dhe me na njoftuar se çka munden me na ndihmu.

Zoran Stanojevic, unë vetëm ju njoftova për gatishmërinë që ka ofruar FSK-ja,ju jeni ata që vendoseni.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, kryesuesi i mbledhjes Zoran Cirkovic, tha pasi që tani e kemi prezent drejtorin SHP,propozoj që të rikthehet përsëri në rend të ditës,Informatë nga Drejtorati për shërbime publike rreth projekteve për vitin 2021.

Pastaj të njëjtën e hodhi në votim,dhe me të gjitha votat prezentë u aprovua propozimi.

IV

Informatë nga Drejtorati për shërbime publike rreth projekteve për vitin 2021

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Zoran Cirkovic, tha se ia kaloj fjalën Rasim Hasanit, drejtorit të SHP, i cili i njoftoi në pika të shkurta rreth projekteve të cilat janë duke u zhvilluar në teren, dhe projektet të cilat janë në fazën e procedurave të prokurimit..

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Lulzim Rustemi,kam dy pyetje e para ka të bëjë rreth lumit Sitnica,a do të vazhdoj puna dhe deri kur do të shkoj. Dhe pyetja e dytë rreth Lumit Janjevka në Lipjan a do të vazhdohet edhe në pjesën tjetër.

Rasim Hasani,projekti për lumin Sitnica nuk kemi informata a do të vazhdoj sivjet,por do t'i rregulloje pjesët e murit ku janë dëmtuar nga vërshimet. Ndërsa sa i përket lumit Janjevka nuk kemi mjete.

Sllavisha Trajkovic,kam një shqetësim për te rruga Lluga-Radevë ku aty puna qe po bëhet nuk po ndërtohen ato anësoret për kalimin e ujit dhe nëse do të ketë reshje të shiut do të ketë vërshime.

Po ashtu kam një falënderim për drejtoratin tuaj për punën që po e bëjnë në pastrimin e varrezave dhe në emër të komitetit ju falënderoj për punën qe po e bëni.

Rasim Hasani,rruga Lluga Radevë,është duke u punuar edhe në atë rrugë do të ketë edhe kanale për kalimin e ujit por para se të vendoset asfaltimi bëhet ajo.

Zoran Cirkovic,në Grackë është duke u bërë punë e mirë rreth asfaltimit të disa rrugicave por kam një pyetje pse një rrugë ka mbet e pa asfaltuar. Kam një vërejtje për menaxherët e projekteve të cilët nuk po janë bashkëpunues me banorët e fshatit.

Edhe ne jemi falënderues për punën rreth pastrimit të varrezave që po e bëni dhe në emër të komunitetit ju falënderoj.

Rasim Hasani, në Grackë janë asfaltuar shumica e rrugicave, por sa i përket asaj rruge për momentin nuk kemi mjete për ta asfaltuar,dhe nuk po kemi mundësi që me pas një aneks kontratë.

Ne ndihemi mirë që jeni të kënaqur me punën që po e bëjmë dhe të gjithë duhet të jenë falënderues për punët e mira.

Naim Jahiri,kam disa pyetje, rruga,,Afrim Zhitija” deri ku ka shkuar procedurat a do të asfaltohet këtë vit. Po ashtu rruga 4 korsi, përballë komunës kur pritet të përfundoj.

Edhe ne banorët e Sllovisë jemi falënderues për punën që po bëhet rreth pastrimit të varrezave.

Rasim Hasani,sa i përket rrugës „Afrim Zhitia”,pritet që të dal në dëgjim publik për shkak se do të zhvillohen procedurat e shpronësimit. Ndërsa rruga 4 korsi përballë Komunës do të përfundoj në fund të muajit maj.

Lulzim Qerimi,deshat të i njoftoj anëtarët e komitetit lidhur me familjen Gashi nga Janjeva kemi pas një takim së bashku me zëvendës ministrin për kthim dhe mjetet për ndërtimin e shtëpisë janë siguruar vetëm ka mbet që familja ta siguroj një parcelë.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14¹⁵.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i mbledhjës
Zëvendës kryesues Zoran Cirkovic